



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KOMUNËS 07. 02. 2017

01. nr. 020/01-0021992/më /17

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), të nenit 7 të Rregullores për tatim në pronën e paluajtshme, 01. Nr. 110 - 246609, të datë 03.10.2016, të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, me dt. \_\_\_\_\_, merr këtë

V E N D I M

- I. Miratohet vendimi për caktimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave për lirim nga tatimi në pronën paluajtshme.
- II. Anëtarët e komisionit të cekur në pikën I të këtij vendimi janë:
  1. Nazim Cakolli, Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Kryesues;
  2. Florina Rrahmani, Sektori Ligjor, anëtare;
  3. Gentian Berisha, Drejtorja e Financave, anëtar.
- III. Detyrat dhe punët e komisionit të cekur në pikën II të këtij vendimi janë të caktuara në dispozitat e nenit 7 të Rregullores për tatim në pronën e paluajtshme, 01. Nr. 110 - 246609, të datë 03.10.2016.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

I DORËZOHET:

- Anëtarëve të Komisionit,
- Qendrës për shërbime me qytetar.
- Në dosje

07. 02. 2017

*Shpend Ahmeti*

